

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ENNA SOLAR, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për këshillim dhe shërbime, me seli të regjistruar në adresën Zona Ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, dorëzuar përmes avokates Ana Kolevska, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 02.07.2025, mori këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ENNA SOLAR, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për këshillim dhe shërbime, me seli të regjistruar në adresën Zona Ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë PVP Cepheus S.R.L., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli të regjistruar në adresën 45H Drumul Gura Putnei, kati i parë, apartamenti 5, dhoma 1, Rrethi 3, Bukuresht, Rumani, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 30.04.2025, dhe i plotësuar më 16.06.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga ana e ENNA SOLAR, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për këshillim dhe shërbime, me seli të regjistruar në adresën Zona Ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, me të cilin ENNA SOLAR, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për këshillim dhe shërbime, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë PVP Cepheus S.R.L., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli të regjistruar në adresën 45H Drumul Gura Putnei, kati i parë, apartamenti 5, dhoma 1, Rrethi 3, Bukuresht, Rumani, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, shtesat dhe bashkëngjitjet e tij, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

ENNA SOLAR d.o.o. merret me zhvillimin dhe investimin në impiante për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, siç janë centralet solare dhe ato me erë.

ENNA SOLAR d.o.o. është pjesë e grupit ENNA. ENNA është një investitor lider dhe një nga grupet investuese me rritjen më të shpejtë në Kroaci, i cili është i përkushtuar në ofrimin e zgjidhjeve inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë të qëndrueshme për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin e energjisë, ashtu edhe në sektorin e transportit, përkatësisht logjistikës.

ENNA SOLAR d.o.o. është në pronësi 100% të ENERGIJA NATYRALIS d.o.o. për investime dhe menaxhim (ENERGIJA NATURALIS d.o.o. za ulaganje i upravljanje), e cila është në pronësi të shoqërisë SUSTAINABLE SOLUTIONS HOLDING AG, pronar i së cilës është Pavao Vujnovac ("PV"). Pavao Vujnovac është pronari përfundimtar edhe i Grupit FORTENOVA, i cili është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime MERCATOR MACEDONIA SHPKNJP Shkup - në likuidim, me seli në rr. "Ognjan Prica" nr. 1/3-28 mezanin, Shkup – Kisella Vodë, me veprimtari parësore të regjistruar: tregti me pakicë në dyqane të pa specializuara kryesisht me ushqim, pije dhe duhan.

PVP Cepheus S.R.L., është themeluar me qëllim të realizimit të një projekti për ndërtimin e një centrali fotovoltaik, ku Shoqëria e Synuar është pronare ose mbajtëse e të gjithë pasurisë, kontratave, lejeve (dhe të drejtave që lidhen me centralin fotovoltaik "Mihailesti-Bulbucata", me lidhjet përkatëse të rrjetit dhe infrastrukturën tjetër ndihmëse, të vendosur pranë Mihailesti, në qarkun Giurgiu, në Rumani, me një kapacitet prej 68,115 MW.

PVP Cepheus S.R.L., nuk ka prani në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ